



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 28, datë 16.01.2020

PËR
CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË
VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË
FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2 e 89 të ligjit nr.115/2019 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionin dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

VENDOSI:

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatën në nevojë si vijon:

GJYKATA E LARTË

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Saida Dollani dhe Sokol Binaj, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Lartë, çështjen gjyqësore me rekursues: {...}; me objekt: “Zgjerimin e ekstradimit për shtetasin e kërkuar {...}, i cili është ekstraduar më datë 10.11.2017 nga Shqipëria në Republikën e Gjermanisë .

2. Gjyqtarët e Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Saida Dollani dhe Sokol Binaj, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Lartë, çështjen gjyqësore me rekursues: {...}; me objekt: “Miratimin e zgjerimit të ekstradimit për shtetasin e kërkuar {...} ({...}), sipas kërkesës së autoriteteve serbe, në zbatim të urdhër arrestit Nr.2.K500/14, datë 14.06.2016 të Gjykatës Themelore Jagodine, akuzuar për veprën penale “Vjedhje e rëndë” dhe urdhër arrestit Nr.KPP-89/17, datë 20.03.2017 të Gjykatës së Lartë Beograd, i cili akuzohet për veprën penale “Prodhim pa leje dhe hedhje në qarkullim të narkotikëve”.

II. Një kopje e vendimit t'i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR